

# *Parahistoria dhe historia antike e Kosovës*

*Edi Shukriu*

## *Përmbledhje*

Territori i Kosovës ka ofruar material të konsiderueshëm arkeologjik, i cili, i kombinuar me të dhënat e burimeve të shkruara antike, mundëson konstatimin se banorët e parë të njohur të saj ishin ilirët (Herod. Historiae IV 49), rrjedhimisht dardanët, të krijuar nga gërshetimi i substratit neolitik dhe të adstratit eneolitik indoevropian. Formësimi i plotë i dardanëve u zhvillua gjatë epokës së hekurit (1200-400), kur dardanët krijuan territorin e tyre kompakt dhe i dhanë vendit emrin Dardania.

Kosova përbënte territorin qendror të Dardanisë, e cila shtrihej në hapësirën midis lumenjve Vardar, Dri, Moravë dhe Timok.<sup>1</sup> Zhvillimi paraurban dardan i shekujve VI-IV solli krijimin e shtetit dardan dhe bashkë me të dhe identitetin dardan, të ruajtur deri në periudhën bizantine.

*Fjalët kyç:* territori Kosovës, materiali arkeologjik, substrati neolitik, adstrati eneolitik, Dardanët, epoka e hekurit, lumenjtë Vardar, Drini, Morava, Timok, identiteti dardan, periudha romake, labirinthe dardan, krishterimi i hershëm, migrimet indo-europiane, shteti dardan, nekroplet tumulare të Kosovës.

---

<sup>1</sup> Fanula Papazoglu, *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba* (Sarajevo, 1969), 143-161; Edi Shukriu, *Dardania paraurbane* (Pejë, 1996), 19 dhe literatura.